



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 24/01/2013
Nr.0204 - 11- 2

PËR: Blerim Kuçi, Kryetar i Komunës së Suharekës
Veseli Maliqaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Suharekës

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SUHAREKËS,
01 Nr. 16- 8563

Pranuar me datë: 04/01/ 2013

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores së Qeverisë 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit, të miratuar me datë 28/12/2012, **KONFIRMON** ligjshmërinë e aktit dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i cili ka efekt të plotë juridik:

- Vendimi 01 Nr. 01 - 8563 NTSH "DHHED", me seli në Suharekë Rruga Parku i dëshmorëve, me person përgjegjës Ramadan Limaj, i Jepet në shfrytëzim afat shkurt deri në 10(dhjet) vite, hapësira publike për gjatë rrugës "Brigada 123" në Suharekë, për ushtrimin e veprimtarisë për vendosjen e "tabelave dhe panove reklamuese", sipas rekomandimit të komisionit për shqyrtimin e ofertave;

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së
Drejtorëve të Departamenteve dhe Drejtorëve të Zyrave
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum, 24/01/2013
Br. 0204-11-2

Za: Blerim Kuçi, Gradonačelnik opštine Suva Reka
Vesel Maliqaj, Predsedavajući Skupštine opštine

Predmet: Potvrda zakonitosti odluka opštine Suva Reka,
Br.01 br. 01 - 8563

Prilmljeno dana ,04/01/ 2013

Poštovani/e

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, u skladu sa njenim mandatom definisano zakonom br. 03/z-040 o lokalnoj samoupravi br. 03/z-040, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije premijera i ministarstva, nakon razmatranja odluka 01 br. 01 - 8563; 01 br. 16-9564, odobreno dana 28/12/2012, **POTVRĐUJE zakonitost ovog akta i procenjuje da isti taj je u potpunom skladu sa zakonom o loklanoj samoupravi .**

Pravni aktovi sa potpunim pravnim dejstvom su kao što slede:

- Odluka 01 br. 01 - 8563 NTSH "DHHED", sa sedištem u Suvoj Reci , ulica Park boraca , sa odgovornim licem Ramadan Limaj, kojim se daje na kratkoročno korišćenje do 10(deset godina javna prostorija duž ulice "Brigada 123" u Suvoj Reci , za vršenje delatnosti o postavljanju "bilbordova ", prema preporuci komisije za razmatranje ponuda;

Sa poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik premijera i Ministar MALS-a,

Kopija: Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVA
 KOMUNA E SUHAREKËS
 OPSTINE SUVA REKA
 THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA



KUVENDI I KOMUNËS SUHAREKË
 REPUBLIC OF KOSOVA - MUNICIPALITY OF SUHAREKA

DËRGUAR - DËSTAVLJENO - SENT

Nr. Br. No.	Data Datum	Salla Sediste Hq	Adresa Adresa
01-16 8569	31.12. 2012	SUHAREKË	PRISHTINE

HYRJE E ULAZNA - INCOMING
 REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA
 QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
 Ministry of Local Government Administration

Data Datum: 04.01.2013

Ijësia organizative	Nr. i Lëndës	Shtojca	Vlera
-111-	0204-19	2	

Për: Ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal në Prishtinë
 - Departamentit Ligjore

Nga: Avni Bytyçi – Shef i Shërbimit të Kuvendit në Suharekë

Lënda: Akt përcjellës

Data: 31 dhjetor 2012

I/e nderuar,

Me anë të kësaj shkrese Ju përcjellim Rregulloret dhe Vendimet e miratuara nga Kuvendi i Komunës në Suharekë, Nga një kopje të vendimeve ju dërgojmë për shqyrtim të ligjshmërisë konform nenit 81, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr-03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës 28/2008).

Lista e akteve të cekura më lartë:

Nr.	Emri i Rregullores apo i Vendimit	Data e Miratimit
1.	Vendimi për dhënien në shfrytëzim afate shkurt deri në 10, (dhjetë) vite të pronës publike	28.12.2012
2.	Vendim mbi formimin e komisionit komunal i aksionarëve	28.12.2012

Andaj kërkojmë nga Ju që konform nenit 81, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr-03/L-040, të bëni shqyrtimin e ligjshmërisë dhe në afat sa më të shkurtë të na ktheni përgjigje me shkrim lidhur me ligjshmërinë e këtyre vendimeve.

Me respekt,



Shefi i Shërbimit të Kuvendit

Avni Bytyçi
 Avni Bytyçi

Kopje:
 MAPL-së
 Arkiva



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS – SUHAREKË
MUNICIPAL ASSEMBLY - SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Ne baze te neneve 12, paragrafi 2, shkronja (c), 14 dhe 17, te Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008), neneve 15, 29, pika 2, të Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, dhe konform nenit 5, 6, 7 dhe 8, të Ligjit për dhënin në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme te Komunës, Nr-03/L-226, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-89/2010), Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, 28.12.2012, mori këtë:

V E N D I M

Neni 1.

NTSH “DHHED”, me seli në Suharekë, Rr. “Parku i Dëshmorëve, me person përgjegjës Ramadan Limaj, i Jepet në shfrytëzim afate shkurt deri në 10, (dhjetë) vite, hapësira publike për gjatë rrugës “Brigada 123” në Suharekë, në emër të pasurisë shoqërore Kuvendi Komunal në Suharekë, për ushtrimin e veprimtarisë për vendosjen e “tabelave dhe panove reklamuese”, sipas rekomandimit të komisionit për shqyrtimin e ofertave.

Neni 2.

Afati për shfrytëzimin e hapësirës publike fillon të rrjedh nga data, **28.12.2012**, dhe përfundon afati më datën, **27.12.2022**, pas mbarimit të këtij afati ose ndërprerjes së parakohshme të marrëveshjes e drejta e shfrytëzimit i kthehet Komunës.

Neni 3.

Obligohet firma e cekur në **nenin 1**, të këtij vendimi që në xhirollogarinë e Komunës së Suharekës, **1000650290000096** të paguaj shumën financiare në vlerë prej **401.00€**, **për muaj**, sipas ofertës të dhen në procedurat e ofertës publike.

Neni 4.

Obligohet firma e cekur në **nenin 1**, të këtij vendimi, që hapësirën publike të cekur në këtë vendim, ta shfrytëzon me mirëbesim si nikoqir i mirë, që mos t’ia humbë vlerën e saj dhe gjatë vendosjes së tabelave dhe panove reklamuese, t’i përmbahet Planit Zhvillimor Urban, Planit Zhvillimor Komunal dhe planeve rregulluese.

Hapësira publike në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Suharekës dhe si e tillë ajo nuk mund t’i epet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.

Neni 5.

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 7, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr- 28/2008) dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË

01-Nr- 16 - 8563
Më datë 31.12.2012



Kryesuesi i Kuvendit

Veseli Maliqaj
Veseli Maliqaj